



Nr. 01/24

Datë: 28.02.2024

Prishtinë

Në mbështetje të nenit 9 pika 2 të Statutit të Fakultetit të Studimeve Islame (në tekstin e mëtejshëm FSI), në mbështetje të vendimit nr. 70/24 të Këshillit Mësimor Shkencor të FSI-së, KMSH miratoi këtë:

UDHËZUES PËR PRAKTIKËN STUDENTORE

Neni 1

Dispozitat e përgjithshme

Me Udhëzuesin për praktikën studentore në FSI, (në tekstin e mëposhtëm "Fakulteti"), përcaktohen dhe rregullohen çështjet:

- Mënyra e organizimit të punës praktike studentore
- Qëllimi i praktikës studentore
- Puna praktike semestrare
- Vizita praktike studentore
- Mbikëqyrësi i praktikës studentore
- Përgjegjësia e studentit për praktikën studentore
- Përgjegjësia e Fakultetit për praktikën studentore
- Përfitimet e studentit nga praktika studentore
- Subjektet potenciale për punë praktike nga studentët
- Mënyra e monitorimit të praktikës studentore
- Format e evidencës për praktikë studentore

Neni 2

Organizimi i punës praktike studentore

Puna praktike e studentëve realizohet nëpër Këshillat e BI-së për fushat përkatëse, ndërsa një pjesë e saj mund të realizohet në Medresenë e Mesme „Alauddin“ dhe paralelet e saja. Studenti në punën praktike, paraprakisht i ka të përcaktuara objektivat e punës të cilat ndërlidhen me kurrikulën mësimore dhe njëkohësisht reflekton në mënyrë aktive në atë çka është duke mësuar. Në vartësi të fushës së studimit përcaktohet edhe lloji i praktikës, mbështetur në programin akademik (syllabus), që monitorohet duke vlerësuar me notë dhe kreditë (ECTS-të) e caktuara.

Neni 3

Qëllimi i praktikës studentore

Qëllimi i kryerjes së punës (mësimit) praktike të studentëve është ndërlidhja e njohurive-aftësive teorike me punën praktike në vend real të punës me çka studentët aftësohen më mirë në profesionin e përzgjedhur.

Neni 4

Puna praktike

Puna praktike organizohet mbështetur në programin akademik (syllabus), i cila monitorohet nga mësuesi i lëndës dhe imami i kualifikuar, ose nëpunësi përkatës i Këshillit, duke u vlerësuar me notë dhe fituar ECTS kreditë.

Neni 5

Mbikëqyrësi i praktikës studentore

Për organizimin dhe funksionimin e punës praktike përgjegjës është prodekani në bashkëpunim me profesorin e lëndës – praktikës:

- Harton listën e studentëve që do të kryejnë praktikën profesionale.
- Në fillim të vitit akademik, informon studentët për detyrimin e praktikës profesionale, si dhe për mundësitë dhe subjektet që i ofron studentëve për zhvillimin e saj, duke mos

përzgjedhjen individuale të studentëve, kur ato janë në përputhje me kuadrin ligjor.

- Përgatit programin e praktikës dhe mënyrën se si do të monitorohet procesi nga stafi akademik.

Neni 6

Profesori i punës praktike profesionale

- Koordinon me studentin realizimin e programit, ndryshimet në zhvillimin e praktikës brenda limiteve të lejuara. Gjithashtu, ndihmon dhe garanton që praktika të realizohet në mënyrën e duhur;
- Planifikon dhe koordinon me subjektin, zhvillimin e praktikës, sipas programit;
 - Në fund të praktikës, profesori vlerëson studentin, bazuar në raportin e vlerësimit të subjektit ku është kryer praktika, i cili ndikon në vlerësimin e vlefshmërisë së praktikës në bashkëpunim me mentorin për vlerësimin e punës praktike dhe profesionale.

Neni 7

Përgjegjësia e studentit për praktikën studentore

- ✓ Të respektojë rendin shtëpiak dhe normat etike të institucionit;
- ✓ T'i ndjekë udhëzimet e koordinatorit / personit përgjegjës të praktikës; të jetë i rregullt në vendin e praktikës sipas marrëveshjes me institucionin dhe koordinatorin e punës praktike;
- ✓ Të jetë bashkëpunues dhe të ketë sjellje korrekte, të punojë në ekip me të gjithë të punësuarit në institucion dhe të përcjellë udhëzimet e imamit/mualimes së xhamisë;
- ✓ Të përfundojë me sukses detyrat e kërkuara;
- ✓ Të lajmërojë me kohë mentorin/imamin nëse do të mungojë në punë praktike (për arsye shëndetëdore ose ndonjë arsye tjetër);
- ✓ Të jetë i kujdesshëm gjatë punës;
- ✓ Të plotësojë ditarin e punës praktike.

Neni 8

Përgjegjësia e Fakultetit për praktikën studentore

Fakulteti është i obliguar që studentëve t'u mundësoj kryerjen e mësimit praktik të studentëve. Mësimdhënësi i lëndës është personi përgjegjës për pajisjen e studentëve me njohuritë e nevojshme, varësisht prej natyrës së punëve që kryen studenti gjatë realizimit të mësimit të punës praktike.

Neni 9

Përfitimet e studentit nga praktika studentore

Nga puna praktike studentët përfitojnë në perfeksionimin e profesionit të tyre, i cili do të shërbejë gjatë gjithë jetës dhe është i bazuar në lidhjen e mësimnxënies gjatë përcjelljes së leksioneve të cilat më vonë realizohen drejtpërsëdrejti gjatë kryerjes së punëve praktike.

Neni 10

Subjektet potenciale për punë praktike nga studentët

Duke pasur parasysh programet mësimore me të cilat funksionon, Fakulteti është i orientuar në lidhjen e marrëveshjeve bashkëpunuese me Këshillat e BI-së dhe medresetë për kryerjen e punëve praktike të studentëve, si në vijim:

- Faljen e namazeve ditore;
- Faljen e namazit të xhumasë;
- Leximin e Kuranit;
- Pjesëmarrjen në ceremonitë e varrimit;
- Mbajtja e ligjëratave;
- Mbajtja e mësimbesimt.

Neni 11

Mënyra e monitorimit të praktikës studentore

Mënyra e monitorimit të praktikës së punës studentore kryhen në përputhje me nenin 6 dhe 7 të këtij Udhëzuesi. Në raste të veçanta monitorimi për vijueshmëri dhe suksesshmëri mund të bëhet edhe nga persona të tjerë që caktohen me vendim të veçantë nga menaxhmenti i Fakultetit.

Neni 12

Format e evidencës për praktikë studentore

Studentët nga Fakulteti, sipas udhëzuesit janë të obliguar të përfundojnë një periudhë dy (2) mujore të punës praktike në Këshillat e BI-së në Kosovë (dy (2) ditë brenda një jave), ose në vendet nga vijjnë studentët. Praktika studentore ka për qëllim që të bëhet ndërlidhja e pjesës teorike të mësimit nga lënda përkatëse me pjesën praktike, në mënyrë që studentet të jenë sa më të përgatitur për tregun e punës.

Dokumentacioni i evidencës së realizimit të punës praktike të studentëve është i klasifikuar në: Formular për praktikë studentore. Në bazë të këtij formulari duhet të jenë të përfshira të gjitha të dhënat për subjektin (Këshillin), studentin dhe personi përcjellës nga Këshilli apo Fakulteti.

Neni 13

Raporti i punës praktike

Gjatë kryerjes së praktikës profesionale, studenti është i detyruar që përgatis raportin e punës praktike dhe profesionale me njohuri dhe informacione që ka fituar gjatë saj. Në raport studentin duhet të paraqes qëllimin e praktikës, argumentet që do jenë baza e praktikës profesionale. Në fund të praktikës profesionale, studenti dorëzon raportin, si dhe vlerësimin, apo mendimin e udhëheqësit të institucionit / këshillit ku është kryer praktika profesionale. Studentët duhet të paraqesin ditarin e punës dhe në bazë të ditarit plotësohet raporti i punës praktike.

Neni 14

Vlerësimi

Vlerësimi është rezultati final i punës praktike, i cili do të shërbejë për qëllim të përmirësimit të cilësisë në Fakultet apo institucionin pritës.

Të gjithë elementët e përmendura në marrëveshje duhet të përmbushen. Studenti do të vlerësohet në institucionin pritës, përmes formularit të vlerësimit nga mbikëqyrësi i tij / saj dhe do t'i jepet një vlerësim përfundimtar bazuar në pjesëmarrjen e aftësimin, aftësitë dhe qëndrimet, si dhe arritjet e tij/saj.

Studenti duhet të paraqesë të gjitha dokumentet relevante profesorit dhe koordinatorit të praktikës pas përfundimit të punës praktike.



Neni 15
Dispozitat përfundimtare

Ky udhëzues hyn në fuqi nga dita e miratimit në KMSH

Neni 16

Ndryshimet dhe plotësimet e këtij udhëzuesi bëhen me procedurë të njëjtë me atë të miratimit të saj.

Në vijim janë të bashkangjitura shtojca nr. 1, 2 dhe 3 e Udhëzuesit.

Shtojca nr. 1

Vizitë Praktike

FORMULAR PËR PRAKTIKË STUDENTORE

Emri i Këshillit - Institucionit ku kryhet praktika studentore

Adresa e Këshillit – Institucionit

Student-i/et nga Fakulteti i Studimeve Islame i Prishtinës, sipas udhëzuesit janë të obliguar të përfundojnë një periudhë të caktuar kohore të punës praktike në këshillat relevante që veprojnë në Kosovë dhe rajon. Praktika studentore ka për qëllim që të bëhet ndërlidhja e pjesës teorike të mësimit nga lënda përkatëse me pjesën praktike, në mënyrë që studentët të jenë sa më të përgatitur për tregun e punës. Student-i/Ët (mund të jene grup i studenteve):

Lënda: 1. KURAN, 2. FIKH – JURISPRUDENCË ISLAME, 3. DAVE

Objektivat e praktikës:

1. Zbatimi i njohurive teorike të përfituara gjatë studimeve dhe praktikimi i tyre;
2. Ushtrimi dhe metodologjia e ligjërimit në praktikë;
3. Krijimi i raporteve të mira me xhematë.

Periudha kohore e praktikës: Date: Prej: ____/____/____ Deri: ____/____/____

Rezultati nga praktika:

- a) Shumë i mirë b) I mire c) I kënaqshëm d) Mjaftueshëm
e) I pamjaftueshëm

Vërejtje apo komente eventuale:

Data:

Mbikëqyrësi:

Profesori i FSI-së dhe Zyrtari i Këshillit

Vendi:

Shtojca nr. 2

Praktika semestrare:

I nderuari kryetar i Këshillit të Bashkësisë Islame në: _____, ju falënderojmë që keni pranuar studentin e FSI-së, i cili është në programin e studimeve “Teologji Islame”, që të kryejë pjesën praktike në Këshillin tuaj.

Ne së bashku do të bëjmë notimin e studentit _____ andaj, luteni që të jepni mendimin tuaj profesional për sa kohë studenti ka qenë i pranishëm në Këshillin Tuaj.

1. Vijimi:

Vijimi	Data	Nënshkrimi i imamit	Nënshkrimi i studentit
Java I			
Java II			
Java III			
Java IV			
Java V			
Java V1			
Java VII			
Java VIII			

2. Interesimi në praktikë:

Shkëlqyeshëm	Shumë mirë	Mirë	Mjaftueshëm	Dobët

3. Shkathtësitë:



Shkëlqyeshëm	Shumë mirë	Mirë	Mjaftueshëm	Dobët

4. Sjelljet:

Shkëlqyeshëm	Shumë mirë	Mirë	Mjaftueshëm	Dobët

Profesori:

Kryetari i Këshillit:

Puna e studentit gjatë hartimit të elaboratit (seminarit):

1. Të dhënat e Këshillit ku keni mbaruar praktikën,
2. Lloji i aktivitetit që është realizuar,
3. Pjesëmarrja në aktivitete fetare,
4. Përshtypjet rreth organizimit të jetës fetare,
5. Vërejtjet dhe sugjerimet e studentit

Vërejtje apo koment eventual nga Këshilli:



Shtojca nr. 3

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
në mes të:
FAKULTETIT TË STUDIMEVE ISLAME - PRISHTINË
dhe
KËSHILLIT TË BASHKËSISË ISLAME NË _____

Në frymën e zhvillimit të një edukimi universitar sa më të afërt me parimet Islame, me datën xx/xx/xxxx, Fakulteti i Studimeve Islame i Prishtinës (më poshtë si "Fakulteti"), i përfaqësuar nga Dekani prof. asoc. dr. Islam Hasani dhe Këshilli i Bashkësisë Islame në _____ (më poshtë si "Këshilli"), përfaqësuar nga z. _____, hynë në një marrëveshje bashkëpunimi ndërinstitucionale.

Qëllimi i marrëveshjes

I.

Qëllimi i kryerjes së mësimit praktik ka të bëjë me lidhshmërinë e mësimnxënies teorike me punë praktike, për arritje më të mëdha dhe avancim të diturisë, të parapara me planet dhe programet mësimore të Fakultetit, por edhe dobiprurëse për një progres më të mirë të institucioneve dhe organeve tona.

Objekti i marrëveshjes

II.

Objekti i marrëveshjes është:

- I. Realizimi i vëzhgimit praktik të studentëve të Fakultetit, në Këshillin e BI-së në fushën e njohurive fetare dhe praktikës së tyre.
- II. Zhvillimi i temave të diplomës duke ju mundësuar studentëve, krahas udhëheqjes teorike/shkencore, udhëheqjen praktike të punës së diplomës,
- III. Angazhimin e Fakultetit në zgjidhjen e problemeve praktike/shkencore të ndërlidhura me jetën fetare në teren.

Mënyra e realizimit të marrëveshjes

III.

Studentët e vitit të I (parë) të II (dytë) të III (tretë) dhe IV-t të Fakultetit në Këshill-Xhami do të kryejnë vëzhgimin praktik një ditë në një muaj (tetë herë gjatë një Viti akademik).

Gjatë tërë kohës së kryerjes së mësimit praktik, studentët do të jenë të udhëhequr nga mësimsdhënësit e lëndëve adekuate, duke respektuar të gjitha normat dhe dispozitat ligjore të Këshillit-Xhamisë e cila mundëson aftësimin praktik për studentë.

Studentëve dhe personelit tjetër nuk u lejohet hyrja në xhami pa prezencën e Imamit që është i caktuar nga Këshilli i BI-së. Studentët janë të obliguar të veprojnë në bazë të rekomandimeve dhe porosive të Imamit. Për këtë duhet të informohen paraprakisht nga udhëheqësi (mësimsdhënësi) i studentëve, por do të informohen edhe para vizitës nga Imami. Studentët mund të pyesin personelin mësimsdhënës apo përfaqësuesin e kompanisë për atë çka u intereson, por nuk lejohet të marrin ndonjë vetiniciative për ndonjë aktivitet brenda objektit. Për çdo veprim që e kryejnë studentët jo komfor udhëzimeve, këshilli nuk mban përgjegjësi, por përgjegjësia bie mbi mësimsdhënësin apo Fakultetit.

Efekt i marrëveshjes

Marrëveshja shtrinë efekt që nga dita e nënshkrimit nga palët dhe do të realizohet përgjatë tërë vitit akademik.

Ndërprerja e marrëveshjes

Kohëzgjatja e marrëveshjes nuk është e limituar, ndërsa mund të shkëputet me paralajmërim prej 30 ditë më parë nga cilado palë nënshkruese .



NËNSHKRUESIT

Dekani

Prof. asoc. Dr. Islam Hasani

Kryetari i Këshillit

Z. XXXXXX XXXXXX

Prishtinë, me: xx.xx.xxxx

**Prishtinë,
28.02.2024**

DEKANI


Prof. asoc. dr. Islam Hasani